



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.18, datë 02. 05. 2012

**PËR
DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I TIRANËS DEPUTETIT TË
PARLAMENTIT ITALIAN FRANCO FRATTINI**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës, personalitetit të shquar, Deputetit të Parlamentit Italian z. Franco Frattini, si dhe mbështetur në nenin 7, pika 2, nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenin 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Tiranës personalitetit të shquar të politikës italiane dhe asaj europiane, Deputetit të Parlamentit Italian Z. Franco Frattini, ish Zv. President i Komisionit European i ngarkuar për Çështjet e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë dhe ish Ministër i Jashtëm i Italisë përgjatë procesit të anëtarësimit në NATO dhe heqjes së vizave për qytetarët shqiptarë, me motivacionin:
2. *“Për kontributin e çmuar për lëvizjen e lirë të qytetarëve shqiptarë në zonën Schengen dhe integrimin euroatlantik të Shqipërisë “.*
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI